



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:261999

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810694

KA.nr.208/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “ERPO PRINT”, SH.P.K., me seli në Gjakovë, rruga “Tirana”, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Bajram Morina nga Gjakova, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, adresa rruga “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, përfaqësuar sipas autorizimit nga Arlinda Morina me kërkesë për anulimi të Vendimit PSH.Nr.533/15 dhe Nr. 537/15 të datës 29.12.2015, i nxjerr nga OSHP si dhe Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritetit Kontraktues i Komunës së Gjakovës me numër të prokurimit 632-15-059-111 i datës 23.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 03.05.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit avokat Bajram Morina dhe të përfaqësuesit të palës së paditur sipas autorizimit Arlinda Morina, më datë 14.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit “ERPO PRINT”, SH.P.K., me seli në Gjakovë, rruga “Tirana, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).
- II. **KONSTATOHET** i kundërligjshëm Vendimit PSH.Nr.533/15 dhe Nr. 537/15 të datës 29.12.2015, i nxjerr nga OSHP dhe Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritetit Kontraktues i Komunës së Gjakovës me numër të prokurimit 632-15-059-111 i datës 23.11.2015.

III. **REFUZOHET** propozim që detyrohet Autoriteti Kontraktues tutje (AK) Komuna e Gjakovës që paditësit t’ia kompensoj dëmin real, në shumë të përgjithshme prej 13,015.99 euro, sipas ekspertizës financiare.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 16.06.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi “ERPO PRINT”, me seli në Gjakovë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 147/16, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit tutje (OSHP), me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit PSH.Nr.533/15 dhe Nr. 537/15 i datës 29.12.2015 i të paditurës OSHP, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të anulohet vendimi PSH.nr.533/15 dhe Nr.537/15 i datës 29.12.2015 si dhe njoftimi për dhënie të kontratës i Komunës së Gjakovës i datës 23.11.2015 me nr. të prokurimit 632-15-059-111, të detyrohet Autoriteti Kontraktues tutje (AK) Komuna e Gjakovës që paditësit t’ia kompensoj dëmin real material, në shumë të përgjithshme prej 18,750.00 euro, respektivisht në lartësinë e shumës e cila konstatohet me nxjerrjen e provës së ekspertizës financiare.
2. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.147/16 të datës 09.04.2021 ka refuzuar si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit “ERPO PRINT”, për anulim të vendimit PSH.Nr. 533/15 dhe nr. 537/15 të datës 29.12.2015. Ndaj këtij Aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë më datë 24.05.2021, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
3. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 208/23.
4. Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.659/22 më datë 10.05.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit

“ERPO PRINT”, SH.P.K., të datës 24.05.2021 dhe lëndën e ka kthyer Gjykatës së Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

5. Gjykata e shkallës së parë më datë 22.01.2024 mbajti seancë përgatitore, ndërsa më datë 03.05.2024 mbajti seancë të shqyrtimit kryesor dhe publik, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat Bajram Morina sipas autorizimit të datës 26.01.2016 dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur Arlinda Morina, sipas autorizimit të datës 09.01.2024 si dhe me pjesëmarrje të ekspertes A.G..

Pretendimet e paditësit

6. Përfaqësuesi i paditësit në padi në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrës në tenderin “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit 632-15-059-111, të publikuar nga Komuna e Gjakovës si Autoritet Kontraktues, tutje (AK) i hapur më datë 19.10.2015, nga Komisioni i AK-së, në prezencë të personave të autorizuar të pjesëmarrësve të tenderit, kusht i tenderit çmimi me i ulët. Sipas raportit të Komisionit të vlerësimit të datës 19.10.2015 është konstatuar se konzorciumi “Litografia” & D.P.SH “Print Net”, ka ofruar çmimin prej 149,208.00 euro, kurse në hapjen e tenderit më datë 19.10.2015, është konstatuar se ky konzorcium ka ofruar çmim prej 122,850.00 euro ndërsa paditësi me hapjen e tenderit më datë 19.10.2015 ka ofruar çmimin prej 46,807.70 euro. Ka shtuar se komisioni vlerësues në vërejtjet përmbyllëse ka konsideruar se çmimet e paditësit janë gjëja abnormalisht të ulëta, kështu që më datë 12.11.2015 ju ka drejtuar KRPP-së për njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët.
7. Paditësi përmes letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 23.11.2015 të lëshuar nga Komuna e Gjakovës si AK është informuar se është shpallur i papërgjegjshëm për shkak të çmimeve abnormalisht të ulëta, ndërsa i pa kënaqur me vendimin e AK-së, ka parashtruar ankesë, më datë 04.12.2015 në Organin Shqyrtues të Prokurimit tutje (OSHP), ndërsa paneli shqyrtues i prokurimit ankesën e ka hedhur poshtë si të pa lejuar, duke e aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e “Graff Tek”, si dhe ka anuluar vendimin e AK Komunës së Gjakovës duke e kthyer lëndën në rivlerësim, konform nenit 72 të LPP-së, me qëllim të verifikimit të certifikatës së dizajnit për

dizajnerin e “Graf-Tek”, Z.Grajçevci për të vërtetuar faktin se kjo certifikate a është lëshuar nga organi kompetent për lëshimin e certifikatave të tilla.

8. Tutje ka theksuar se vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim të plotë me konstatimet e ekspertizës nga ekspertja shqyrtuese të datës 18.12.2015, pa dhënë arsytetime valide me arsytetime formale se paditësi nuk ka qenë i përgjegjshëm për shkak të çmimeve abnormalisht të ulëta, edhe pse paditësi në procedurën e tenderit ka deponuar prova dëshmi se çmimet janë reale, duke dorëzuar tender të përgjegjshëm më çmim më të ulët, pasi që paditësi ka ofruar çmime më të ulëta se fituesi i tenderit, prej 46,807.70 euro, ndërsa konzorciumi fitues në hapje të tenderit ka ofruar shumën prej 122,850.00 euro, e cila shumë pastaj është rritur për motive të panjohura nga ana e Komisionit Vlerësues të AK-së në 149, 208.00 euro, respektivisht është rritur për 26, 358.00 euro, më shumë krahasuar me çmimin e publikuar me rastin e hapjes së tenderit, me çka vërtetohet se oferta e paditësit edhe e përgjegjshme, ndërsa eliminimi paditësit është bërë në kundërshtim me nenin 60 par. 1 nën par. 1.1 i LPP-së. Ka theksuar se me leximin e raportit të ekspertës shqyrtuese të datës 18.12.2015 të cilën e ka anashkaluar i padituri pa dhënë arsytetime ligjore vërtetohen pretendimet e paditësit, lidhur me pavlefshmërinë e vendimit të AK-së për ta shpallur si të pa përgjegjshëm paditësin i nxjerrë me shkelje të rënda të dispozitave të LPP-së, përkatësisht neni 7, 28, 32, 52, 54, 56, 60, 71, ngase me specifikimet teknike të tenderit të caktuar nga AK i është dhënë prioritet konzorciumit me ç’rast dyshohet se bëhet fjalë për përshtatje të tenderit, konkretisht për favorizim dhe përshtatje për OE fitues N.T.SH. “Litografia” & D.P.SH “Print Net”.
9. Përfundimisht ka theksuar se me shikimin e dosjes së tenderit vërtetohet se nënshkrimet e anëtarëve të komisionit vlerësues janë falsifikuar, fakt që vërtetohet me krahasimin e nënshkrimeve në listën e çmimeve, me nënshkrimet nga procesverbali hapjes, ku janë korrigjuar shumat ashtu që në hapje janë paraqitur mbi 122,850.00 mijë euro, kurse pas kësaj në vlerësim është shënuar shuma mbi 149,208.00 euro. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi PSH.nr.533/15 dhe Nr.537/15 i datës 29.12.2015 si dhe njoftimi për dhënie të kontratës i datës 23.11.2015, me numër të prokurimit 632-15-059-111, i Komunës së Gjakovës, ndërsa bazuar në faktin se Ligji për Prokurimin Publik, lejon mundësinë që OE të parashtroj për kompensim dëmi kundër AK-së që ka shkelur ligjin në dëm të OE-së, në bazë të nenit 119 par.3 të LPP-së i ka propozuar gjykatës që të detyroj AK-në që paditësit

t'ia kompensoj shumën e shpenzimeve për përgatitjen e Dosjes së Tenderit në shumë të përgjithshme prej 2,000.00 euro, si dhe kompensimin e dëmit për pjesën e fitimit të humbur në shumë prej 16,750.00 euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 18,750.00 euro, respektivisht në lartësinë e shumës e cila konstatohet me nxjerrjen e provës së ekspertizës financiare.

Kundërshtimet e të paditurës

10. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtresës së datës 18.01.2017, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ka deklaruar se më datë 03.12.2015 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën Nr. 533/15 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Erpo Print” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës, me nr.të protokollit. 632/15/059/111, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës. OSHP pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, e cila në raportin e datës 18. 12. 2016, ka konstatuar se ankesat e OE ankues janë pjesërisht të bazuara dhe në përputhje me nenin 114 pika 2 e LPP-së, duke konstatuar se ankesa e OE ankues të hidhet poshtë si e pa lejuar kundër vendimit të AK-së konform nenit 111 par. 1 pika 5.8 lidhur me nenin 41 pika 1 par.26 i LPP-së, për faktin se këtë OE AK e ka shpallur të pa përgjegjshëm për çmime jo normalisht të ulëta në përputhshmëri me nenin 61 pika 4 e LPP-së. I ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar në ligj.

Provat e administruara

11. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me nr.533/15, 537/15, më datë 24.12.2015, ekspertiza nga ekspertja shqyrtuese e prokurimit Sh.H., me date 15.12.2015, ankese kundër autoritetit kontraktues Komuna e Gjakovës nga paditësi “Erpo Print”, me datë 04.12.2015, njoftim për dhënie të kontratës me date 23.11.2015, raport i vlerësimit të tenderëve me nr. të prokurimit 632/15/059/111, me titull rishpallje furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës, njoftim nga “Erpo Print”, lidhur me pretendimet për çmime jo normalisht të ulët, dosja e tenderit e paditësit “Erpo Print”, me

çmimet e ofruara, ekspertize financiare e punuar nga ekspertja gjyqësorë A.G., më datë 29.03.2024.

12. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaramet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit si pjesërisht të bazuar.
13. Nga Vendimi i kundërshtuar PSH.Nr. 533/15 537/15 paneli shqyrtues e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE “Graf-Tek”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës, në pikën II është hedhur poshtë si e pa lejuar ankesa e OE “Erpo Print”, kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës, në pikën III është anuluar vendimi i AK Komuna e Gjakovës me nr. të prokurimit 632.15/059/111, dhe lënda është kthyer në rivlerësim, konform nenit 72 të LPP-së me qëllim të verifikimit të certifikatës së dizajnit për dizajnerin Z. G., se e njëjta a është lëshuar nga institucioni kompetent i regjistruar pran institucioneve të Kosovës për lëshimin e këtyre, me arsyetim se AK nuk ka vepruar në përputhshmëri me nenin 72 të LPP-së duke e shpallur të papërgjegjshëm OE “Graf Tek”, për shkak të certifikatës së dizajnit për dizajnerin grafik Z. G. si dhe kontratën e këtij dizajneri, pa i verifikuar se autoriteti a ka qenë kompetent dhe i autorizuar për të lëshuar dokumente të këtilla apo e njëjta certifikatë është falsifikuar. Ndërsa, Paneli shqyrtues ka konstatuar se ankesa e OE “Euro-Print”, me nr. 537/15 të hidhet si e palejuar kundër vendimit të AK-së për faktin se është shpallur i pa përgjegjshëm për çmim jo normalisht të ultë, në përputhshmëri me nenin 61 pika 4 i LPP-së.
14. Nga ekspertiza e ekspertes shqyrtuese e prokurimit Sh.H. e datës 15.12.2015 Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës financiare të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe krahasimit me oferta financiare për pozicione të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë mendon se AK-ja, nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik i cili ka ofertuar me çmime tejet normalisht të larta për shumë pozicione në ofertën e tij financiare, dhe me këtë rast AK-së, do ti shkaktonte shpenzim të pa

nevojshëm të buxhetit për artikuj që do të mund ti kishte me çmim shumë më të lira. Eksperti e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e OE ankues e datës 06.11.2015 se OE i shpërblyer me kontratë ka ofertuar me një çmim prej 122,850.00 euro, por është shpërblyer me një çmim prej 149,208.00 euro me një diferencë prej 26,358.00 euro, duke ngritur dyshime për keqpërdorim të parasë publike të Komunës.

15. Për vlerësimin e çmimit të OE fitues ka dhënë disa shembuj: OE i shpallur fitues me artikullin Nr.6 - Tapete me montim oferton me një çmim prej 8.00€ për m2, çmim që është abnormalisht i lartë, ndërsa për artikujt Nr.7 - Tapete me vrima me montim dhe artikullin Nr.8 - Tapete akull ngjyrë hiri me montim oferton me çmime prej 1.00€ për m2. Artikujt Nr. 7 dhe 8 janë me çmim më të lartë se sa artikulli nr.6 dhe kanë dallime abnormale në kalkulime. Lidhur me këtë ekspertit shqyrtues sqaron nga krahasimi i ofertave financiare të gjithë Operatoreve ekonomik për këtë pozicion vjen në përfundim se është i qëndrueshëm pretendimi i ankuesit. a. Shembulli 2: Artikulli Nr.12 - Fotokopje A4 bardh e zi ofrohet me një çmim prej 0.10€ për copë, ndërsa artikulli Nr.14 - Fotokopje A3 bardh e zi ofertohe me një çmim prej 0.06€ për copë. Artikulli nr.14 është dyfish më i madh në format dhe ka dyfishin e kostos së printimit në krahasim me artikullin nr. 12, ndërsa OE e oferton artikullin më të lirë me një çmim prej afro dyfish më të lartë se sa çmimi i artikullit më të shtrenjtë, sepse çmimi me pakicë për një fotokopje A4 bardh e zi është 0.02€ ose 0.015€ për copë e sidomos në afërsi të Universiteteve apo shkollave.
16. Pra ekspertit ka konstatuar se OE i shpallur fitues ofron një çmim pese apo gjashtë here me të lartë se sa çmimi i tregut me pakice dhe kjo konsiderohet si normale nga AK. Përderisa operatoret ekonomik tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit për pozicionin nr. 12 kanë ofertuar me çmim prej 0.02 €; 0.01 €, 0.02 €, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për këtë pozicion ka ofertuar me çmim prej 0.10 € (sasia 80000), sipas mendimit të ekspertit shqyrtues çmimi prej 0.10 € e dhënë nga fituesi është i lartë nëse i krahasojmë me ofertat tjera dhe çmimin real të tregut.
17. Shembulli 3: Artikulli nr. 18 - Ftesa A 4 kolor 300 gr dy ane shtyp me plastifikim ofertohe me një çmim prej 0.20€ për copë, ndërsa artikulli nr. 19 - Ftesa AS color 300gr dy anë shtyp me plastifikim ofertohe me një çmim prej 0.50C për cope. Artikulli përgjysmë me i vogël me kosto përgjysmë me te ulet te prodhimit ofertohe me një çmim prej 250% me te larte ne krahasim me artikullin dyfish me te madhe, kur krahasohen këta

artikuj me Artikuj nr.39 - Ftesa special me u vllak e që është ofertuar me një çmim prej 0.01C për copë, ndonëse ky artikulli ka koston e prodhimit më të lartë se sa te dy artikujt e lartcekur nr.18 dhe 19 e konsideron si vlerësim absurd. Ndërsa, operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit për artikullin nr.18 dhe 19 kanë ofertuar me çmim prej 0.05€&0.05€, 0.25€&0.30€, 0.01&0.01€, 0.20&0.15, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për këto pozicione ka ofertuar me çmim prej 1.00 €& 0.20 €, e që nëse bëhet krahasimi shihet se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar me çmim ab-normalisht të lart për pozicionet e cekura më lart.

18. Shembulli 4: Artikulli nr.22 Postera B2 50x70 ofertohet me një çmim prej 0.40C për copë ndërsa artikulli nr.27 - Postera B1 100x70 ofertohet me një çmim prej 0.10C. Pra 400% më i shtrenjtë del të jetë artikulli që është 50% me i lirë në realitet. Lidhur me këtë pretendim ankimor ekspertit shqyrtues mendon se nëse bëhet një krahasim në mes të ofertave financiare të ofertuesve tjerë për pozicionin nr. 22, del qe OE tjerë pjesëmarrës për këtë artikull kanë ofertuar me çmim prej: 0.20€, 0.50, 0.30, 0.30€, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka oferta me çmim prej 0.40, Lidhur me këtë pretendim sipas mendimit te ekspertit çmimi i dhënë nga fituesi nuk është shume difference nga të tjerët.
19. Shembulli 5: Artikulli nr.23 - Fletëpalosje A4 kolor 300gr konstrukt me big ofertohet me një çmim prej 0.20€ për copë ndërsa Artikulli nr.30 Fletëpalosje A3 kolor 150gr konstrukt ofrohet me një çmim prej 0.01€ për copë. Dallimi sigurisht qëndron te pesha e letrës e qe është dyfish me e vogël te njeri artikull, por i cili është dyfish më i madh në format dhe pesha e produktit është prapë e njëjtë për copë. Ndërsa çmimi ka një dallim prej 2000% (dy mije për qind), ashtu është ky pretendim është i qëndrueshëm sipas mendimit të ekspertit shqyrtues.
20. Shembulli 6: Artikulli nr.35 - Foto me ram A4 ofertohet me një çmim prej 2.50€ për cope ndërsa Artikulli nr.36 - Foto me ram 50x35 ofertohet me çmim prej 2.00C për copë, ndonëse artikulli 36 është afro dyfish me i madhë se artikulli 35. Lidhur me këtë pretendim ankimor ekspertit shqyrtues mendon se nëse e krahasojmë edhe çmimin e dhënë artikullin nr.35, me ofertat tjerë del se çmimi dhënë nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ta me shumë më te lart se ofertuesit tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet te prokurimit.

21. Shembulli 7: Artikulli nr.51 - Fasikell A3 me plastifikim 350gr ofertohet me një çmim prej 0.05€ për copë ndërsa Artikulli nr.52 - Fasikell A4 me plastifikim 350gr ofertohet me çmim prej 1.00€ për cope. Edhe këtu konsideron se dallimi është dyfish në artikujt e lartcekur, por dallimi në çmimet e ofruara është 20 here me i larte te artikulli me i lire se ai qe ne realitet është me i shtrenjte. Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet te prokurimit për artikullin nr.51. kane ofertuar me çmim prej:0.10€,0.30€,0.05€,0.05€, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës për artikullin në fjale ka ofertuar me çmim prej:0.05€, ndërsa për artikullin nr.52 OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofertuar me çmim prej:1.00€, derisa OE tjerë pjesëmarrës kane ofertuar me çmim prej 0.15€,0.15€,0.30€,0.60€, e që sipas mendimit te ekspertit OE rekomanduar për dhënie te kontratës ka ofertuar me çmim shumë më të lart se OE tjerë pjesëmarrjes për pozicionin nr.52 ka ofertuar me çmim më të lart .

22. Shembulli 8: Artikulli nr. 67 Zarfë me logo A4 është ofertuar me çmim prej 0.20€ për copë , ndërsa Artikulli nr. 69 - Zarfë me logo A3 është ofertuar me çmim prej 0.15€ për copë, e njëjtë me shembullin e lartcekur. Sa i përket këtij pretendimi ankimor eksperti shqyrtues mendon se nëse i referohemi çmimeve te dhëna për disa pozicione nga ana e OE te rekomanduar për dhënie të kontratës dhe krahasimin e tyre me çmime reale të tregut dhe ofertave financiare të OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjale, shihet se oferta financiare e dhënë nga ky OE për disa pozicione është më e lart se çmimet reale të tregut dhe si e tillë ishte dashur të analizohet nga ana e autoritetit kontraktues në mënyrë te detajuar e qe AK-ja, mos të paguaj dyfish për artikuj qe ne çmimin e tregut real, mund të merren shumë më lirë. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës për pozicionin nr.67 ka ofertuar me çmim prej 0.20€, ndërsa OE tjerë kanë ofertuar me çmim prej: 0.15€,0.06€,0.02€,0.02€, që nëse bëhet një krahasim del që oferta e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertua me çmim shumë më të lart për pozicionin në fjalë. Ndërsa nëse bëhet krahasimi i ofertave financiare të OE-ve tjerë dhe OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për pozicionin nr.69 del qe OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka oferta me çmim më të lart se te tjerët.

23. Sa i përket pretendimit të ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë në pozicionet 12 është çmim astronomik lartë sipas tregut në Republikën e Kosovës, Pozicioni

48,49,53,54,84 po ashtu këto pozicione janë çmime jo-normalisht te ulte. Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se për pozicionet e cekura me lart, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar me çmim prej:0.01€,0.02€0.01€,ndersa operatorët tjerë ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar me çmime përafërsisht të njëjta me këtë ofertues. Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës financiare të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe krahasimit me ofertat financiare për pozicione të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë mendon se AK-ja, nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së, për fakti se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik i cila ka ofertuar me çmime tejet normalisht të larta për shumë pozicione në ofertën e tij financiare, dhe me këtë rast AK-së, do të shkaktonte shpenzim të pa nevojshëm të buxhetit për artikuj që do të mund ti kishte me çmim shumë më të lira.

24. Nga Njoftim për dhënie të kontratës, konstatohet se Komuna e Gjakovës më datë 23.11.2015 ka shpallur njoftim për dhënie të kontratës OE N.T.SH “Litografia” dhe D.P.SH “Print Net”, me titull “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit 632-15-059-111, kushtet e tenderit, çmimi më i ulët. Tek informacionet mbi vlerën e kontratës, seksioni IV.5), vlera e përgjithshme e kontratës është përcaktuar 149.208,00€, Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët 149.208,00 €, Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lartë 178.292,00 €,
25. Nga raport i vlerësimit të tenderëve me nr. të prokurimit 632/12/059/111, te datës 27.10.2015 Komisioni i vlerësimit pas shikimit të dokumentacionit të pesë OE, që ofertuar ka konstatuar se tre OE ishin të përgjegjshëm “Erpoprint”, “Agimi-DE”, dhe “Litografia & Print Net”, kurse dy OE ishin të pa përgjegjshëm “Grand Tek”, “Sfinga & “Blini BK”. Komisioni i vlerësimit më datë 04.11.2015 ka kërkuar nga zyra e prokurimit që të kërkoj nga OE “Erpoprint”, që a qëndron pran çmimeve të ofruara për pozicionet 2,6,7,8,32,37,38,55,56,59,60,61,72,75,76,77,78,80,80,81,82,83, 86, dhe është kërkuar arsyeshmëri dhe zbërthim të çmimeve. Nga përgjigja e OE” Erpoprint” e datës 06.11.2015 janë njoftuar se OE “Erpoprint” qëndron pran çmimeve të ofruar në dosjen e tenderit, por duke mos ofruar arsyeshmëri dhe zbërthim të çmimeve për këto pozicione. Më datë 09.11.2015 Zyra e Prokurimit ju ka drejtuar disa OE-ve si Selmans Netëork, Mediatech Print, Euro Printy, Brovina Graf, duke kërkuar çmimet për pozicionet 2,6,7,8,32,37,38,55,56,59,60,61,72,75,76,77,78,80,80,81,82,83,86.

26. Pas verifikimit të çmimeve të prezantuara nga këta OE, është parë se çmimet për pozicionet e lartcekura kanë ndryshim shumë nga çmimet e prezantuara nga OE “Erpoprint”, ndërsa komisioni i vlerësimit ka arritur në përfundim se OE më i përgjegjshëm me çmim më të ulët është OE “Litografia & Print Net”, ku rezulton se çmimi i ofruar është 149.208.00 €, duke e propozuar me nënshkrim të kontratës. Ndërsa sipas procesverbalit të hapjes së tenderit me datë 19.10.2015 kanë ofruar pesë OE: “Erpoprint” me çmim ofertues 46.807.70 €, Graf Tek” me çmim ofertues 62.827.80 €, “Agimi-DE” me çmim ofertues 177.692.00 €, “Litografia & Print Net” me çmim ofertues 122.85.00 €, “Sfinga & “Blini BK” me çmim ofertues 155.500.40 €.
27. Nga njoftim i OE “Erpo Print” lidhur me pretendimet për çmimet jo normalisht të ulët, është deklaruar se qëndrojnë pran çmimeve të ofruara në dosjen e tenderit. Ka deklaruar se artikujt të cilët vlerësohen si jo normalisht të ulët janë artikuj që kompania e tyre punon pa pagesë për partner dhe bashkëpunëtorë të rregullt, sepse janë punime të kompanisë së tyre. Sa i përket furnizimit me lëndë të parë ka deklaruar se si kompani përfitojnë nga zbritjet e konsiderueshme dhe aksionet e furnitorëve, dhe këto produkte për partner dhe bashkëpunëtorë të rregullt i ofrojnë pa pagesë apo me një pagesë të ulët në krahasim me çmimet e tregut, si dhe ka deklaruar se këto produkte nuk kanë ndonjë varësi me produktet e tjera.
28. Në Dosja e Tenderit me çmimet e ofruara , e N.T.SH “Litografia” dhe “Print Net”, numri i prokurimit 059, titulli “Rishpallje e furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës, totali përgjithshëm me të cilin ka ofertuar është 122,850.00 euro (e shtypur), ndërsa po aty është shënuar (me dorë) shume 149,208.00 €. Nuk është dhënë asnjë sqarim për arsyet e korigjimit të totalit të përgjithshëm.
29. Nga ekspertiza financiare punuar nga ekspertja gjyqësore A.G. më datë 29.03.2024, është konstatuar se dëshmi mbi dëmin real material nuk ka të dokumentuar nga paditësi, fitimi i humbur duke u bazuar në dokumentacionet shtesë të pranuar nga paditësi për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës është 13,015.99 ,euro.

30. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP) Neni 6 përcakton Efektivitetin dhe Efikasitetin, paragrafi 1 parasheh se “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”, paragrafi 2 parasheh “Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës” .
31. Neni 7 i LPP-se përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, paragrafi 2 parasheh se “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”. Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “*Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar*”, 1.1 *tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji*”.
32. Neni 61 përcakton Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, paragrafi 1 parasheh se “*Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni. 44,* paragrafi 2 parasheh se “*Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 2.1. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të*

propozuara “, paragrafi 3 parasheh se “Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë” paragrafi 4 parasheh se “Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin” .

Vlerësimi i gjykatës

33. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar.
34. Gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se sa ishte përcaktuar çmimi i parashikuar i kontratës “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës”, me nr. të prokurimit 632-15-059-111, të publikuar nga Komuna e Gjakovës si Autoritet Kontraktues. Aktiviteti i prokurimit ishte hapur më datë 19.10.2015, nga Komisioni i AK-së, ndërsa kusht i dhënies së kontratës ishte çmimi më i ulët. Paditësi kishte ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit publik “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës”, me çmim prej 46,807.70 €.
35. Komisioni i vlerësimit pas shikimit të dokumentacionit të pesë OE ofertues ka konstatuar se tre OE ishin të përgjegjshëm “Erpoprint” me çmim ofertues 46.807.70 €, “Agimi-DE” me çmim ofertues 177.692.00 €, dhe “Litografia & Print Net” me çmim ofertues 122.85.00 €, kurse dy OE ishin të pa përgjegjshëm “Graf Tek” me çmim ofertues 62.827.80 €, “Sfinga & “Blini BK” me çmim ofertues 155.500.40 €.
36. Gjykata vlerëson se AK ka shpallur EO “Erpoprint” me çmim ofertues 46.807.70 €, të papërgjegjshëm me arsyetim se ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët pa dhënë

asnjë sqarim se si e ka bërë verifikimin e çmimeve. Në konstatimin e dhënë në raport të vlerësimit të tenderëve AK thekson se më datë 09.11.2015 Zyra e Prokurimit ju ka drejtuar disa OE-ve si Selmans Netëëork, Mediatech Print, Euro Printy, Brovina Graf, duke kërkuar prej tyre çmime për pozicionet 2,6,7,8,32,37,38,55,56,59,60,61,72,75,76,77,78,80,80,81,82,83,86. Pas verifikimit të çmimeve të prezantuara nga këta OE, është parë se çmimet për pozicionet e lartcekura kanë ndryshim shumë nga çmimet e prezantuara nga OE “Erpoprint”. Gjykata vlerëson se AK për të ardhur deri të ky konstatim nuk ka dhënë asnjë detaj se cilat produkte kishin dallime të çmimeve, sa i ishte vlere në treg e secilit produkt dhe sa ishte diferenca çmimit të ofertuar nga OE ankues këtu paditësi.

37. Po ashtu gjykata vlerëson se AK respektivisht Komisioni i vlerësimit të tenderëve ka ardhur në përfundim se OE më i përgjegjshëm me çmim më të ulët është OE “Litografia &Print Net”, pa bërë asnjë krahasim dhe vlerësim dhe në kundërshtim me konstatimet e dhëna në ekspertizë të ekspertes shqyrtuese e prokurimit Sh.H. e datës 15.12.2015 ku ishte konstatuar se AK, nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik i cili ka ofertuar me çmime tejet jo normalisht të larta për shumë pozicione në ofertën e tij financiare, dhe me këtë rast AK-së, me çka i ka shkaktuar shpenzim të pa nevojshëm buxhetit për artikuj që do të mund ti kishte me çmim shumë më të lira. Gjykata vlerëson se Ekspertja shqyrtues ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të besueshme se si ka ardhur deri të ky përfundim, duke analizuar çmimet për disa artikuj, duke i krahasuar me çmimet e tregut, çmimet e ofertuara të të gjithë OE ofertues dhe çmimet e ofruara nga OE fitues, (siç përshkruhen në mënyrë të detajuar ne ekspertize dhe ne paragrafin 16-23 të këtij aktgjykimi), dhe në mënyrë të bazuar ka konstatuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar me çmime tejet jo normalisht të lartë për shumë pozicione në ofertën e tij financiare.

38. Gjykata rikujton se vlerësimi i çmimit duhet të bazohet në kritere objektive dhe praktika të qëndrueshme për të siguruar që vendimet nuk janë arbitrare. Përkundër që nga provat e administruara nuk u vërtetuar kriteret për vlerësimin e çmimeve, u vërtetua se Komisioni i vlerësimit të ofertave i AK, konform dispozitave të nenit 61 të LPP-së të cituara më lartë, më datë 04.11.2015 kishte kërkuar nga OE “Erpoprint”, sqarime për çmimeve të ofruara për pozicionet 2, 6, 7, 8, 32, 37, 38, 55, 56, 59, 60,

61, 72, 75, 76, 77, 78, 80, 80, 81, 82, 83, 86, dhe është kërkuar arsyeshmëri dhe zbërthim të çmimeve. Mirëpo, përgjigjen e OE “Erpo Print” lidhur me pretendimet për çmimet jo normalisht të ulët, me të cilën kishte deklaruar *se artikujt të cilët vlerësohen si jo normalisht të ulët janë artikuj që kompania e tyre punon pa pagesë për partner dhe bashkëpunëtorë të rregullt, sepse janë punime të kompanisë së tyre. Sa i përket furnizimit me lëndë të parë kompania përfiton nga zbritjet e konsiderueshme dhe aksionet e furnitorëve, dhe këto produkte për partner dhe bashkëpunëtorë të rregullt i ofrojnë pa pagesë apo me një pagesë të ulët në krahasim me çmimet e tregut, si dhe ka deklaruar se këto produkte nuk kanë ndonjë varësi me produktet e tjera*, gjykata e vlerëson si të pabazuarë në ndonjë provë, sepse nuk është përmenduar asnjë furnitor apo kompani nga të cilat përfiton paditësi zbritje, dhe aq më pak nuk është siguruar asnjë konfirmim i furnitorëve që do të konfirmoni se do ta furnizonin paditësin me çmime të përcaktuara, e të cila do të mbështetnin integritetin e ofertës dhe do të ishin të besueshme për gjykatën.

39. Nga shqyrtimi i provave u konstatua se autoriteti kontraktues ka dështuar ti përcaktoj kriteret transparente dhe objektive për përcaktimin e ofertës me çmim jo- normalisht të ulët. Autoriteti kontraktues mban përgjegjësi për të vendosur kriteret të qarta dhe transparente për vlerësimin e tenderëve, duke përfshirë udhëzimet për identifikimin e ofertave që mund të konsiderohen jo normalisht të ulëta. I gjithë procesi, që nga identifikimi i ofertës jo normalisht të ulët deri te vendimi përfundimtar, duhet të jetë i dokumentuar për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri, por në rastin konkret nuk janë bërë të qarta kriteret objektive të vlerësimit të çminimit nga AK. Kjo është thelbësore për të garantuar transparencën, konkurrencën dhe integritetin e procesit të prokurimit. Nga shqyrtimi i rastit, rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përmbushur detyrën e tij në këtë drejtim.

40. Në parim dështimi i autoritetit kontraktues ti përcaktoj kriteret transparente dhe objektive për përcaktimin e ofertës me çmim jo normalisht të ulët, do të merrej në favor të paditësit. Mirëpo, në anën tjetër, vlerësohet se paditësi ka ofruar sqarimin joadekuat lidhur me ofertën e tyre të cilën AK e ka vlerësuar si jo normalisht të ulët, pra pala në fjalë, pavarësisht se i është dhënë mundësia, nuk ka arritur të japë një sqarim të duhur dhe të besueshëm për të shpjeguar në mënyrë adekuate strategjinë e çmimeve për ofertën e ulët, i njëjti nuk i është përgjigjur kërkesës së datës 04.11.2015 të Komisionit me çka kishte kërkuar zbërthimin e çmimeve, duke e bërë kështu të pasigurt integritetin e ofertës për

prishmërinë e realizimit të kontratës publike me çmimin e ofertuar dhe në rrethana normale të realizonte fitimin e pritshëm.

41. Prandaj mbi këtë bazë gjykata e refuzoj kërkesën për kompensim të fitimit të munguar, sepse për realizimi të fitimit të munguar, përveç vërtetimit të shkeljeve nga AK paditësi do duhej ta dëshmonte bindshëm se i njëjti do ta realizonte kontratën publike me çmimin e ofertuar, në pajtim me Nenin 173 par. 3 i LMD-së, ku përcaktohet se tek fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerret veprimin.
42. Pretendimin e OE ankues/paditësit se me hapjen e ofertave OE i shpërblyer me kontratë ka ofertuar me një çmim prej 122,850.00 euro, por është shpërblyer me një çmim prej 149,208.00 euro me një diferencë prej 26,358.00 euro, duke ngritur dyshime për keqpërdorim të parasë publike të Komunës Gjykata e vlerëson të bazuar. Sepse nga procesverbali i hapjes së tenderit me datë 19.10.2015 u konstatua se në këtë aktivitet kanë ofertuar pesë OE: “Erpoprint” me çmim ofertues 46.807.70 €, Graf Tek” me çmim ofertues 62.827.80 €, “Agimi-DE” me çmim ofertues 177.692.00 €, “Litografia & Print Net” me çmim ofertues 122.85.00 €, “Sfinga & “Blini BK” me çmim ofertues 155.500.40 €. Ndërsa në Njoftim për dhënie të kontratës, Komuna e Gjakovës më datë 23.11.2015 kur shpallet njoftim për dhënie të kontratës OE N.T.SH “Litografia” dhe D.P.SH “Print Net”, me titull “Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit 632-15-059-111, kushtet e tenderit, çmimi më i ulët Tek informacionet mbi vlerën e kontratës, seksioni IV.5), përcaktohet në vlerë e përgjithshme të kontratës 149.208,00€. Ne Dosje të Tenderit me çmimet e ofruara, e N.T.SH “Litografia” dhe “Print Net”, numri i prokurimit 059, titulli “Rishpallje e furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës, rezulton se totali përgjithshëm me të cilin ka ofertuar është 122,850.00 euro (e shtypur), ndërsa po aty është shënuar (me dorë) shume 149,208.00 €. Nuk është dhënë asnjë sqarim për arsytet e korigjimit të totalit të përgjithshëm.
43. Prandaj, gjykata vlerëson se i gjithë procesi i prokurimit konsiderohet me të meta, në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 6, 7, 60, 61 të LPP-së, dhe i njëjti me vendimin e kundërshtuar veq se është anuluar dhe çështja është kthyer ne rivlerësim,

mirëpo konstatimi i kundërligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar PSH.Nr. 533/15 537/15 dhe Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritetit Kontraktues i Komunës së Gjakovës me numër të prokurimit 632-15-059-111 i datës 23.11.2015, (i anuluar me vendimin e kundërshtuar) mund t'i nënshtrohet hetimeve të mëtejshme në lidhje përshtatshmërinë e praktikave të prokurimit dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe llogaridhënjes në procedurat e prokurimit.

44. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.208/23, datë 14.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:261999
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05810694